



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 195, datë 04.06.2020

PËR

**HAPJEN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM PËR POZICIONE
TE LIRA NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” me ndryshime, duke konstatuar edhe cenimin e rendë të funksionalitetit të gjykatës, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Të shpallë dy pozicione të lira pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për transferim të përkohshëm deri në një vit.
2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarëve të transferuar, aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë znj. {...} dhe z. {...}, të cilët të ftohen për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.
3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda dy ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.
4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR